



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të neneve 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dispozitave të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 22/2011, nenit 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Rregullores (QRK)-Nr.17/2015 për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____, 2024 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË KOMUNËN E LIPJANIT PËR VITIN 2023

I.Me këtë vendim **MIRATOHET** Raporti Nr. 02-320/01-9675 i datës 15.02.2024 i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Lipjanit për vitin 2023 .

II. Pjesë përbërse e këtij Vendimi është Raporti Nr. 02-320/01-9675 i datës 15.02.2024 i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Lipjanit për vitin 2023.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e neneve 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr: 28 e datës 4 qershor 2008, dispozitave të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 22/2011, nenit 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Rregullores (QRK)-Nr.17/2015

për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Në pajtim me dispozitat e cekyura ligjore, kërkojmë nga ana e Kuvendit Komunal miratimin e Raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Lipjanit për vitin 2023 me nr. 02-320/01-9675 të datës 15.02.2024.

INr. 320/01-9979
Lipjan, më 16.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me: Primljeno:	15.02.2024	
Njësia Jednica:	Numr. Seri:	Shtojca Dodatak:
02-320/01-9675		

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

REFERENCË:	12 – 320	Data :	15.02.2023
PËR /ZA/TO:	Sektorin e Kuvendit		
NGA/OD/FROM	Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Lipjanit 2023.		
Cc:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës		
PËRMES/ THROUGH:	z. Rexhep Rexhepi – Drejtor i Drejtoratit të Bujqësisë – Lipjan		
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJEKT:	Miratimi i raportit mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Lipjanit gjatë muajit Qershor – Korrik të vitit 2023.		

Në bazë të vendimit 1 Nr. 020/04-30335 të datës 13.06.2023 për formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe moti i ligë në territorin e Komunës së Lipjanit të lëshuar nga Kryetari i Komunës, komisioni ka filluar punën prej datës 14.06.2023-21.07.2023 dhe ka pranuar gjithsej 43 kërkesa të fermerëve të cilët kanë raportuar dëmet nga fshatrat e Komunës të Lipjanit.

Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga Drejtorati i Bujqësisë ka shqyrtuar të gjitha kërkesat në terren dhe ka përgatitur procesverbal për secilin edhe me anë të fotografive të bëra në vendin e ngjarjes.

Çmimet e kulturave bujqësore i kemi bërë duke u bazuar në raportin e gjelbërt të ESK. të vitit 2021 të marra nga MBPZHR.

Mirëpo gjatë dorëzimit të listës dhe lëndëve për kompensim të dëmeve në Agjensionin për Menaxhimin e Emergjencave në Prishtinë na është kërkuar që të formulojmë listën vetëm sipas sipas Ligjit Nr. 4 L – 027, për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe rregullorës Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve.

Gjatë shqyrtimit të lëndëve sipas rekomandimit të AME – së (Agjensionit për Menaxhimin e Emergjencave) vetëm 39 fermerë janë dëmtuar nga vërshimet.

Antarët e komisionit:

Afrim Sadiku

Sadete Maholli

Avni Sahiti